

PROCEDURË TEKNIKE
për kontrollim të funksionimit të makinave të përpunimit të kartëmonedhave dhe
monedhave me të cilat operojnë punonjësit e trajnuar dhe klientët e bankave

Rregullativa ligjore dhe nënligjore në bazë të së cilës është hartuar dokumenti:

Emri i rregullores:	I publikuar në:
Ligji për Bankën Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut	"Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 158/10, 123/12, 43/14, 153/15, 6/16 dhe 83/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 110/21
Vendim për kushtet dhe mënyrën e furnizimit me kartëmonedha dhe monedha	"Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 149/21
Vendim për kushtet dhe mënyrën e mbikëqyrjes së furnizimit me kartëmonedha dhe monedha	"Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 149/21
Vendim për përcaktimin e procedurës së zbulimit dhe tërheqjes së parave të falsifikuara	"Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 42/11
Udhëzim për zbatimin e Vendimit për kushtet dhe mënyrën e furnizimit me kartëmonedha dhe monedha	"Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 169/21

1. Hyrje

Në pajtim me rregullativën ligjore dhe nënligjore të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut (më tutje në tekst: Banka Popullore) bankat dhe qendrat për para të gatshme janë të obliguara të kontrollojnë autenticitetin dhe përshtatshmërinë e parave në qarkullim. Për këtë qëllim, në këtë procedurë teknike është definuar procedura e Bankës Popullore për kontrollimin e mënyrës së funksionimit të makinave për përpunim të kartëmonedhave dhe monedhave të cilat i përdorin bankat dhe qendrat për para të gatshme gjatë kontrollimit të sasisë, autenticitetit dhe përshtatshmërisë për riqarkullimin e kartëmonedhave dhe monedhave.

2. Kërkesë për kontrollimin e makinave

Banka Popullore zbaton testimin e funksionimit të makinave për përpunim të parave në bazë të kërkesës^(*) (Shtojca 5 nga Udhëzimi për zbatimin e vendimit për kushtet dhe mënyrën e furnizimit me kartëmonedha dhe monedha) e cila është paraqitur nga banka, qendra për para të

gatshme, prodhuesi, furnizuesi ose nga përfaqësuesi i autorizuar i atyre makinave në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Në kërkesë shënohen të gjitha të dhënat e nevojshme të cilat i referohen funksionimit të makinës për përpunim të parave.

Të dhënat e paraqitura në Bankën Popullore nuk u prezantohen personave të tretë.

Pas pranimit të kërkesës, Banka Popullore përcakton datë për testim të makinës dhe për për këtë e informon parashtruesin e kërkesës. Testimi i makinës nga prodhuesi ose përfaqësuesi i autorizuar kryhet në hapësirat e Bankës Popullore, përveç në rastat kur transportimi deri te Banka Popullore është i vështirësuar, atëherë testimi i makinës mund të realizohet te kërkuesi.

3. Publikimi i rezultateve të testimit të funksionimit të makinave

Pas testimit të realizuar, Banka Popullore jep vërtetim për realizimin e suksesshëm të testimit të makinës për përpunimin e parave dhe atë për një periudhë të kufizuar kohore prej një viti. Vetëm makinat të cilat e kanë kaluar me sukses procesin e testimit, publikohen në listën e makinave të testuara me sukses për përpunim dhe seleksionim të parave, të cilën Banka Popullore e publikon në faqen e saj të internetit. Bankat dhe qendrat për para të gatshme mund ti vënë në përdorim makinat për përpunim të parave nëse janë të testuara me sukses dhe nëse janë në listën e publikuar në faqen e internetit të Bankës Popullore.

Pas çdo përmirësimi të pjesës harduerike ose softuerike të makinave për përpunim të parave të cilat janë të testuara me sukses, banka, qendra për para të gatshme, prodhuesi, furnizuesi ose përfaqësuesi i autorizuar duhet të paraqesin kërkesë për ritestim të makinës.

4. Kategorizimi i makinave për përpunim të kartëmonedhave

Që të kualifikohet si makinë për përpunim të kartëmonedhave, makina duhet ti përpunojë kartëmonedhat, ti selektojë dhe fizikisht ti ndajë sipas karakteristikave të tyre pa ndërhyrje të punonjësit të trajnuar për punë me makinën, në pajtim me shtojcat II-a dhe II-b nga Vendimi për kushtet dhe mënyrën e furnizimit me kartëmonedha dhe monedha.

Makinat për përpunim të kartëmonedhave duhet të kenë mundësinë e përshtatjes së softuerit për njohjen e emetimeve të reja ose shtypjeve të reja të parave. Përveç kësaj, ato duhet të jenë të përshtatshme që të mundësohet vendosja e më shumë ose më pak standardeve (nivele) restriktive të sortimit, nëse ka nevojë.

Kategoritë e makinave për përpunim të kartëmonedhave janë:

I. Makina me të cilat operojnë klientët e bankave, me këto nënkategori:

Tabela 1

1	Makina për depozitim të parave të gatshme (Cash in Machines - CIMs)	Këto makina u mundësojnë klientëve të depozitojnë kartëmonedha në llogaritë e tyre bankare duke përdorur kartelën bankare, por nuk kanë funksion për lëshimin e kartëmonedhave. CIM e kontrollojnë autenticitetin e kartëmonedhave dhe mundësojnë ndjekjen e të dhënave të klientit të bankës – pronarit të llogarisë. Kontrollat e përshtatshmërisë për qarkullim nuk janë të detyrueshme.
2	Makina për depozitim dhe tërheqje të parave të gatshme	Këto makina u mundësojnë klientëve të bankës të depozitojnë dhe të tërheqin kartëmonedha në/nga llogaritë e tyre bankare, duke përdorur kartelën bankare. CRM kontrollojnë autenticitetin dhe përshtatshmërinë e

	(Cash recycling machines - CRMs)	kartëmonedhave dhe mundësojnë ndjekjen e të dhënave të klientit të bankës – pronarit të llogarisë. Për tërheqje, makinat mund të përdorin kartëmonedha autentike dhe të përshtatshme të depozituara nga klientët e tjerë të bankës në transaksionet e mëparshme.
3	Makina të kombinuara për depozitim të parave të gatshme (Combined cash in Machines - CCMs)	Këto makina u mundësojnë klientëve të bankës të depozitojnë dhe të tërheqin kartëmonedha në/nga llogaritë e tyre bankare duke përdorur kartelën bankare. CCM kontrollojnë autenticitetin e kartëmonedhave dhe mundësojnë ndjekjen e të dhënave të klientit të bankës – pronarin e llogarisë. Kontrollat e përshtatshmërisë për qarkullim nuk janë të detyrueshme. Për tërheqje, makinat nuk i përdorin kartëmonedhat e depozituara nga klientët e tjerë të bankës në transaksionet e mëparshme, por vetëm kartëmonedha të ngarkuara veçmas në to.
Makina të tjera me të cilat operojnë klientët e bankës		
4	Makina për tërheqje të parave të gatshme (Cash out Machines - COMs)	Këto makina zakonisht janë bankomate të cilat e kontrollojnë autenticitetin dhe përshtatshmërinë e kartëmonedhave për qarkullim para se të tërhiqen nga klientët e bankës. COM përdorin kartëmonedha që ngarkohen nga punëtorët e bankave – të cilët bëjnë përpunimin manual të kartëmonedhave ose nga sisteme tjera automatike.

II. Makina me të cilat operojnë punonjës të trajnuar, me këto nënkategori:

Tabela 2

1	Makina për përpunim të kartëmonedhave (Banknotes processing machines - BPM)	Makina të cilat kontrollojnë autenticitetin dhe përshtatshmërinë e kartëmonedhave për qarkullim, fizikisht i ndajnë paratë e dyshuara dhe të pa përshtatshme për qarkullim nga ato autentike dhe të përshtatshme për qarkullim.
2	Makina për përcaktim të autenticitetit (Banknote authenticity machines - BAM)	Makina të cilat kontrollojnë autenticitetin e kartëmonedhave dhe bëjnë përzgjedhjen dhe klasifikimin e kartëmonedhave në autentike dhe të dyshuara duke hedh të dyshuarat.
3	Makina për kthimin e parave në qarkullim me ndihmën e punëtorëve - arkëtarë (Teller assistant recycling Machines - TARMs)	Makina me të cilat operojnë punonjësit e trajnuar me anë të të cilave e kontrollojnë autenticitetin dhe përshtatshmërinë e kartëmonedhave në qarkullim. Për tërheqje, TARM mund të përdorin kartëmonedha autentike dhe të përshtatshme për qarkullim të cilat i kanë depozituar klientët tjerë në transaksionet e mëparshme. Për më tepër, ata në mënyrë të sigurt i ruajnë kartëmonedhat dhe u mundësojnë punonjësve në banka t'i miratojnë ose kreditojnë llogaritë e klientëve të bankave.
4	Makina me ndihmën e punëtorëve - arkëtarë	Me këto makina operojnë punonjës të trajnuar të cilët kontrollojnë autenticitetin e kartëmonedhave. Për më tepër, ato i ruajnë kartëmonedhat të sigurta dhe u

	(Teller assistant machines - TAMS)	mundësojnë punonjësve në banka t'i miratojnë ose kreditojnë llogaritë e klientëve të bankave.
--	------------------------------------	---

Makinat nga të dy kategoritë nevojitet të mundësojnë përpunimin dhe klasifikimin e kartëmonedhave dhe monedhave në pajtim me Vendimin për kushtet dhe mënyrën e furnizimit me kartëmonedha dhe monedha. Për emetimet e reja ose printimet/farkëtimet e kartëmonedhave/monedhave, Banka Popullore me kërkesë të prodhuesit ose furnizuesit të makinave, siguron mostër të kartëmonedhave/monedhave për përshtatjen përkatëse të makinës.

Në Tabelën 1 dhe Tabelën 2 nuk janë të përfshira:

Pajisjet për autentifikim të kartëmonedhave të cilat përpunojnë kartëmonedhë të vetme ose një seri kartëmonedhash pa ndërhyrjen e përdoruesit, i klasifikojnë paratë si autentike ose të dyshuara, por pa mundësinë për ndarje fizike automatike të kartëmonedhave të dyshimta nga autentiket;

Pajisjet për autentifikim të kartëmonedhave të cilat kërkojnë nga përdoruesi vetë të vendos nëse paraja është autentike ose jo (psh.ndihmëse për verifikim).

5. Kontrollimi i funksionimit të makinave dhe zbatimi i tyre

Banka Popullore kryen testime të të gjitha kategorive të makinave për përpunim dhe selektim të kartëmonedhave të cilat janë theksuar në Tabelën 1 dhe Tabelën 2.

Për atë qëllim Banka Popullore vendos procedura për testimin e llojeve të ndryshme të makinave për përpunim të kartëmonedhave.

Qëllimi i këtyre testeve është kontrollimi i aftësisë së llojit (modelit) të caktuar të makinave për përpunim të kartëmonedhave, me sukses të bëjë ndarjen e kartëmonedhave autentike nga ato të dyshuarat ("test për zbulimin e falsifikateve") dhe nëse është e zbatueshme, të bëjë klasifikimin e kartëmonedhave sipas përshtatshmërisë së tyre për qarkullim ("test për kontrollimin e funksionit klasifikim"). Për makinat e operuara nga klientët e bankës, kontrollohet edhe funksionimi i drejtë i sistemit për ndjekje të përdoruesit ("test të sistemit të ndjekjes").

Testimet realizohet me përdorimin e një seti të parave nga të gjitha denominimet të cilat janë në qarkullim, të përbëra nga kartëmonedha autentike dhe të falsifikuara, siç do të theksohet më poshtë. Duke pasur parasysh se në çdo kohë mund të paraqiten kartëmonedha të reja të falsifikuara me karakteristika të ndryshme nga ato të parave që janë përdorur gjatë testimit, duhet të merret parasysh se rezultatet e testeve të publikuara në faqen e internetit të Bankës Popullore vërtetojnë vetëm aftësinë e atij lloji të makinës për përpunim të kartëmonedhave për zbulimin e falsifikateve të përfshira në testin e përdorur në ditën e realizimit të testimit.

Rrjedhimisht, Banka Popullore u bën thirrje prodhuesëve/distributorëve ti ndjekin ndodhitë në fushën e falsifikimit dhe rregullisht ti përditësojnë/përmirësojnë makinat e tyre për t'u siguruar që falsifikatet e reja mund të detektohen gjithashtu në mënyrë të besueshme.

Të gjitha testet i ndjekin procedurat e njejta dhe kryhen në bashkëpunim me prodhuesit/distributorët e makinës.

5.1 Kontrollimi i aftësisë së makinës për identifikim të kartëmonedhave të falsifikuara

Testi i zbulimit të falsifikatit kryhet me një set test të standardizuar, i cili përbëhet nga lloje të ndryshme të kartëmonedhave të falsifikuara që gjenden në qarkullim.

Gjatë testimit kontrollohet aftësia e makinave për njohjen e kartëmonedhave të falsifikuara nga të gjitha denominimet, në të gjitha orientimet që i mbështet makina.

Makina për përpunim të kartëmonedhave e kalon testin me sukses nëse:

(a) asnjë nga falsifikatet nga seti i testimit nuk është klasifikuar si kartëmonedha autentike (kategoria 4 ose 5 nga SHTOJCA IIa Tabela 3 ose kategoria 2 ose 3 nga SHTOJCA IIb Tabela 4 nga Vendimi për kushtet dhe mënyrën e furnizimit me kartëmonedha dhe monedha);

(b) për makinat e operuara nga klientët e bankës me mundësi ndjekjeje të transaksionit, 90% nga kartëmonedhat e falsifikuara duhet të klasifikohen në kategorinë 2 dhe 3 (Tabela 3), pra lejohet vetëm 10 % të klasifikohen në kategorinë 1 (Tabela 3).

5.1.1. Kontrollimi i aftësisë së makinave për identifikim të monedhave të falsifikuara

Kontrollimi i aftësisë së makinave për identifikim të monedhave dhe vlerësimi i rezultateve kryhet në mënyrën e njejtë si te kontrollimi i aftësisë së makinave për identifikim të kartëmonedhave të falsifikuara.

5.2 Kontrollimi i afëtsisë së makinave për përcaktim të cilësisë së kartëmonedhave sipas përshtatshmërisë së tyre për qarkullim

Testi i aftësisë së makinave për klasifikim parave ("test për kontrollim të funksionit të klasifikimit") zbatohet me ndihmën e një seti të kartëmonedhave autentike të cilat nuk janë të përshtatshme për qarkullim dhe tregojnë shenja të konsumimit dhe defekteve të shkaktuara nga përdorimi i përditshëm dhe sasi të caktuar të kartëmonedhave autentike, të përshtatshme për qarkullim.

Testi realizohet në mënyrë që makina testohet me të gjitha orientimet e mundshme të mbështetura nga makina.

Testimi është i suksesshëm nese jo më shumë nga 5% të kartëmonedhave të papërshtatshme për qarkullim klasifikohen dhe fizikisht ndahen në kategorinë 4 (Tabela 3) ose kategoria 2 (Tabela 4) nga Aneksat IIa ose IIb të Vendimit për kushtet dhe mënyrën për furnizim me kartëmonedha dhe monedha, përkatësisht edhe të gjitha kartëmonedhat nga vlerat nominale dhe/ose emetimet të cilat nuk janë të mbështetura nga makina ose të futura në makinë në orientimet të cilat nuk janë të mbështetura nga ajo, refuzohen nga makina.

5.2.1. Kontrollimi i aftësisë së makinave për përcaktim të cilësisë së monedhave sipas përshtatshmërisë së tyre për qarkullim

Kontrollimi i aftësisë së makinave për përcaktim të cilësisë së monedhave sipas përshtatshmërisë së tyre për qarkullim dhe vlerësimi i rezultateve kryhet në mënyrë të njejtë sikur edhe te kontrollimi i aftësisë së makinave për kartëmonedha.

5.3 Kontrollimi i sistemit për monitorim të transaksionit

Testi i sistemit për monitorim të transaksionit, i cili zbatohet vetëm për makinat me të cilat operojnë klientët e bankës, është i suksesshëm nëse makina për përpunim të kartëmonedhave ruan të dhëna për pronarin e llogarisë për të gjitha paratë e klasifikuara në kategoritë 2 dhe 3

(Tabela 3) nga Aneksi IIa nga Vendimi për kushtet dhe mënyrën e furnizimit me kartëmonedha dhe monedha dhe në mënyrë të besueshme i lidh të gjitha këto para me të dhënat për pronarin përkatës të llogarisë.